

V E N D I M
Nr.330, datë 9.7.1993

PËR LIKUIDIMIN NGA LLOGARITË LIKUIDUESE NË VALUTË TË DETYRIMEVE
BUXHETORE

Për zbatimin e neneve 8 dhe 17 të ligjit nr.7681, datë 4.3.1993 "Për administrimin e tatimeve dhe taksave në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Detyrimet ndaj Buxhetit të Shtetit që rrjedhin nga tatimet dhe taksat, kur llogaria likuiduese në lekë nuk ka gjendje, do të likuidohen nga llogaria likuiduese në valutë e subjekteve ekonomike.
 2. Kur për likuidimin e detyrimeve ndaj Buxhetit të shtetit përdoret llogaria likuiduese në valutë e subjekteve ekonomike, gjendja në valutë e tyre për shumën e detyrimit konvertohet në lekë, sipas kursit të shpallur nga Banka e Shqipërisë në ditën përkatëse.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi